

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2495/2 Prot.

Durrës, më 02.12.2025

V E N D I M

Nr. 105, Datë 02.12.2025

PËR

“MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT ME DIPLOMË TË DYSFISHTË, TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË “KOMUNIKIM, TEKNOLOGJI DHE MEDIA DIGJITALE”, PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE, TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës ME UNIVERSITETIN “SAPIENZA” ROMË, ITALI”

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, “Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësite kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësite kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar”; në Statutin e UAMD-së; në Rregulloren e UAMD-së; vendim Senati Akademik nr.169, datë 27.11.2025, Bordi i Administrimit

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit përbashkët të studimit me diplomë të dysfishtë, të ciklit të parë, Bachelor në “Komunikim, Teknologji dhe Media Digjitale”, pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës me Universitetin “Sapienza” Romë, Itali, për vitin akademik 2026-2027.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 25000 lekë.
3. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhët **Shqip/Anglisht**
4. Kodi i programit të studimit: **63BA0388S**